



Partia Politike
“BASHKIMI DEMOKRATIK”



STATUTI

Drenas , 2024



PËRMBAJTJA

STATUT	3
DISPOZITAT THEMELORE.	4
EMËRTIMI DHE SELIA.....	4
PARIMET.....	4
DETYRAT TJERA.....	4
PËRBËRJA, ORGANET, KUVENDI.....	5
DETYRAT E KUVENDIT	5
KËSHILLI I PËRGJITHSHËM.....	5
KRYETARI.....	6
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM.....	6
NËNKRYETARËT.....	7
KRYESIA.....	7
SEKRETARI JURIDIK.....	8
KOMISIONI I REVIZIONIT DHE KONTROLLIT.....	8
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET STATUTORE	8
ANËTARËSIMI.....	9
ARKATARI.....	9
BARAZIA GJINORE DHE PËRFAQËSIMI NË ORGANET E BD.....	9
SHPËRBËRJA APO SHUARJA E PARTISË.....	9
HYRJA NË FUQI.....	9



Bazuar në Nenin 7, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe Ligjit nr. 03/072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL) dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122, si dhe Nenit 11 të Nenin 11 të Rregullës Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe Funkcionimi i Partive Politike, Kuvendi Themelues i partisë politike “Bashkimi Demokratik Drenas” më 20.05.2024 miratoi këtë:

STATUT

“Bashkimi Demokratik” është subjekt politik i bazuar në parimet liberale të qendrës, me theks të veçantë në barazinë sociale, mundësitë e barabarta për të gjithë, lirinë e shprehjes së mendimit, bashkëpunimin dhe solidaritetin në mes qytetarëve, aktivizimin qytetar e rinor, trajtimin e drejtë e të barabartë të grupeve të marginalizuara etj.

"Bashkimi Demokratik" u formua falë vullnetit të qytetarëve dhe angazhimit të Këshillit Nismëtar të këtij subjekti politik, mbi bazat demokratike, për një shtet, ku sundojnë rendi dhe ligji, ku respektohen të drejtat dhe liritë qytetare në Republikën tonë demokratike, me orjentim pro përendimor, pro vlerave euroatlantike, NATO-s dhe ShBA-së.

"Bashkimi Demokratik", angazhohet për shtet të së drejtës, nëpërmjet votës së lirë e demokratike, me ekonomi funksionale, dhe mirëqenie të qytetarëve në harmoni me vlerat dhe standardin evropian.

Partia "Bashkimi Demokratik" është formuar mbi bazat e vlerave kombëtare, në Kuvendin e saj të datës 15.09.2024.

Si parti e qendrës, "Bashkimi Demokratik" është një formacion politik i pozicionuar në mënyrë të balancuar në spektrin politik, duke kombinuar elemente të politikës së majtë dhe të djathtë, që kërkon të ofrojë zgjidhje të moderuara, që përpiqet të përmbush interesat e një grupi të gjerë qytetarësh, pa u angazhuar plotësisht për ideologji të ekstremist të majtë ose të djathtë.

"Bashkimi Demokratik" përqendrohet në politika pragmatike dhe mund të ndihmojë në krijimin e koalicioneve për të adresuar çështje të ndryshme sociale dhe ekonomike.

Vizioni i "Bashkimit Demokratik" është synimi për shtetin e së drejtës, ku qytetarët e Republikës së Kosovës do të ndjehen të barabartë në të gjitha fushat e jetës.

Për realizimin e interesave të veta, "Bashkimi Demokratik" bashkëpunon me partitë politike brenda dhe jashtë vendit, kurse për realizimin e synimeve të veta përdor mjetet parlamentare dhe jo parlamentare.

BD-ja është subjekt politik i qytetarëve të barabartë që veprojnë në bazë të statutit për t'i realizuar objektivat programore, me të drejtë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

- 1) Me këtë Statut rregullohet organizimi, udhëheqja dhe themelimi i organeve, përfaqësimi juridik i partisë në Republikën e Kosovës dhe në institucionet e saj, sikur edhe i shumë çështjeve tjera të rëndësishme të "Bashkimit Demokratik".
- 2) "Bashkimi Demokratik" është subjekt i pavarur i qytetarëve.
- 3) "Bashkimit Demokratik" lufton për mbrojtjen dhe përparimin e interesave ekonomike, sociale, juridike, kulturore dhe të interesave të qytetarëve.

Neni 2

"Bashkimi Demokratik" lufton për realizimin e të drejtave të qytetarëve në harmoni me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, duke iu përmbajtur ligjeve për organizim dhe



mbrojtje të drejtave të qytetarëve, nëpërmjet zgjedhjeve demokratike.

EMËRTIMI DHE SELIA

Neni 3

- 1) Emërtimi i plotë i partisë është: "Bashkimi Demokratik".
- 2) Shkurtesa: BD
- 3) Selia e Bashkimit Demokratik është në Drenas, rr. Bedri Shala pn.
- 4) Emblema dhe flamuri

Neni 4

- 1) "Bashkimi Demokratik" e ka vulën e rrumbullakët, vulën katrore, emblemën dhe librezën e anëtarësisë.
- 2) Vula e rrumbullakët përmbajnë emrin, selinë dhe emblemën e BD-së, në mes në gjuhën shqipe dhe angleze.
- 3) Vula katrore ka formën e katërkëndëshit kënd drejtë e cila përmban shënime nga Neni 3 dhe 2 përveç emblemën, duke lënë hapsirë të zbrazët për numrin e protokollit dhe datën.
- 4) Emblema e "Bashkimit Demokratik" është logo e partisë, që shërben si shenjë dalluese e saj.
- 5) Libreza është shenjë identifikuese e secilit anëtar të "Bashkimit Demokratik".

Neni 5

"Bashkimi Demokratik" është person juridik me status të posaçëm ligjor.

PARIMET

- 1) Anëtarësimi i lirë nëpërmjet deklaramit me shkrim në partinë "Bashkimi Demokratik", bëhet në degë dhe nëndegë të kësaj partie.
- 2) Parimi i demokratizimit të plotë duke respektuar pluralizmin politik.
- 3) Parimi i nismave me interes të përgjithshëm partiak.
- 4) Parimi i krijimit të parakushteve për pjesëmarrje në pushtet, nëpërmjet zgjedhjeve demokratike dhe votës së lirë, me qëllim të ushtrimit të funksioneve të institucioneve demokratike në nivel qendror e lokal, për interesa të qytetarëve.
- 5) Parimi i propozimit dhe përkrahja për zgjedhje në organet e partisë të atyre individëve të cilët me cilësitë e tyre njerëzore, morale e profesionale në mënyrë të drejtë përfaqësojnë interesat e qytetarëve.
- 6) Në organet e partisë nuk mund të jenë individët, që janë anëtarë dhe pjesë e strukturave të ndryshme partiake.
- 7) Parimi i respektimit të dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës krahas angazhimit të zbatimit e tyre adekuat.

DETYRAT TJERA

Neni 6

"Bashkimi Demokratik" krijojnë fondin dhe sigurojnë mjete nga anëtarësia, donacionet vullnetare, kontributet e ndryshme të anëtarësisë dhe nga ndihmat e tjera që nuk bien ndesh me ligjin.

Neni 7

Lartësia e anëtarësisë për anëtarët e "Bashkimit Demokratik" në marrëdhënie pune është 5 euro.



Neni 8

Shpërndarja dhe mënyra e përdorimit të mjeteve të grumbulluara rregullohet me një rregullore të veçantë.

Neni 9

PËRBËRJA E "BASHKIMIT DEMOKRATIK"

- 1) "BASHKIMIN DEMOKRATIK" e drejton Kryesia prej 15 anëtarëve, të cilin e udhëheq Kryetari .

Neni 10

ORGANET E "BASHKIMIT DEMOKRATIK"

I. Organet e Bashkimit Demokratik janë:

- 1) Kuvendi
- 2) Këshilli i Përgjithshëm
- 3) Kryesia

II. Për kryerjen e detyrave të caktuara themelohen edhe komisione tjera administrative ad hoc.

Neni 11

KUVENDI

- 1) Kuvendi është organi më i lartë i BD-së dhe përbëhet prej 21 anëtarëve.
- 2) Vendimin për thirrjen e Kuvendit e merr Këshilli i Përgjithshëm, së paku dy muaj më herët nga data e mbajtjes së Kuvendit.
- 3) Kuvendi i punës mbahet një herë në vit.
- 4) Kuvendi mund t'i zhvillojë punimet nëse të pranishëm janë 2/3 e delegatëve.
- 5) Në Kuvend përfaqësimi është sipas çelësit, në çdo 15 anëtarë një delegat.
- 6) Sipas kërkesës së Këshillit të Përgjithshëm, Kryesisë dhe 1/3 e degëve mund të mbahet edhe Kuvendi i jashtëzakonshëm.
- 7) Nëpër degë veprohet në mënyrë analoge.
- 8) Seancat e Kuvendit drejtohen nga Kryetari i partisë

Neni 12

DETYRAT E KUVENDIT

- 1) Hartimi e miratimi i Programit dhe Statutit të "Bashkimit Demokratik".
- 2) Zgjedhja e kryetarit me mandat katërvjeçarë.
- 3) Zgjedh Këshillin e Përgjithshëm prej 30 anëtarëve me mandat katërvjeçarë.
- 4) Shqyrton dhe miraton Raportin e punës të Këshillit të Përgjithshëm.
- 5) Vendimet e Kuvendit merren me shumicë të thjeshtë të votave të delegatëve të pranishëm.

Neni 13

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM

- 1) Këshilli i Përgjithshëm me 30 anëtarë është organi më i lartë në mes dy kuvendeve. Këshilli takohet një herë në vit.
- 2) Takimin e jashtëzakonshëm të Këshillit të Përgjithshëm të "Bashkimit Demokratik" ka të drejtë ta thërras Kryesia me shumicë votash.
- 3) Këshilli i Përgjithshëm i propozon Kuvendit miratimin e buxhetit vjetor.

- 4) Këshilli i Përgjithshëm zgjedh Kryesinë e "Bashkimit Demokratik" prej 15 anëtarësh me mandat 4 vjeçarë.
- 5) Me propozimin e Kryetarit, Këshilli i Përgjithshëm zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm dhe nënkryetarët.
- 6) Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm do të mbahet nëse janë të pranishëm mbi gjysma e anëtarëve.
- 7) Këshilli i Përgjithshëm bën kontrollimin e punës së Kryesisë së Bashkimit Demokratik.
- 8) KP-ja gjatë mandatit ka të drejtë t'i shkarkojë deri 1/3 e anëtarëve të Kryesisë.
- 9) Këshilli i Përgjithshëm merr vendim për organizimin e formave të rezistencës.
- 10) Kryen edhe punë të tjera të parapara me këtë statut.

Neni 14 **KRYETARI**

- 1) Përfaqëson partinë "Bashkimi Demokratik".
- 2) I raporton Këshillit, Kryesisë dhe Kuvendit të BK-së.
- 3) Koordinon punët e organeve të BK-së.
- 4) Informon nëpërmjet zëdhënësit publikun për veprimtarinë e BK-së.
- 5) Nënshkruan akte të ndryshme në emër të BK-së.
- 6) Në emër të Kryesisë së BK-së merr vendime me urgjencë dhe për këtë njofton Kryesinë dhe Këshillin e Përgjithshëm.
- 7) Drejton mbledhjet e Kryesisë, të Kuvendit dhe të Këshillit të Përgjithshëm.
- 8) Përcjell zbatimin e detyrave, që dalin nga Kryesia dhe Këshilli i Përgjithshëm.
- 9) Për çfarëdo çështje programore, politike, zgjedhore e partiake, vendimi i Kuvendit është përfundimtar dhe obligativ, prandaj zbatohet nga secili organ tjetër brenda BD-së.
- 10) Zgjidhet në Kuvend me mandat katërvjeçarë, në mandatin e parë, me aklamacion, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 11) Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit.

Neni 15 **SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

- 1) Është përgjegjësi kryesor administrativ për çështje të përgjithshme të funksionimit të partisë.
- 2) Kujdeset për organizimin e punës së Kryesisë, administratës dhe arkivit të BD.
- 3) Komunikon dhe bashkëpunon në mënyrë profesionale me subjektet dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
- 4) Komunikon dhe bashkëpunon në mënyrë profesionale me subjektet dhe institucionet e Republikës së Kosovës, veçanërisht me KQZ-në.
- 5) Për punën e vet i përgjigjet Kryetarit, Kuvendit dhe Këshillit të Përgjithshëm.
- 6) Sekretari i Përgjithshëm ka përgjegjësi kryesore për administrimin dhe menaxhimin e brendshëm të partisë.
- 7) Ai/ajo ndihmon në organizimin e aktiviteteve të partisë, mbikëqyrë funksionimin e strukturave dhe siguron që vendimet e marra nga organet drejtuese të zbatohen në mënyrë efikase. Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm, luan një rol të rëndësishëm në komunikimin dhe koordinimin me anëtarët e partisë dhe mund të përfaqësojë partinë në takime dhe aktivitete të jashtme.
- 8) Ka të drejtë ta përfaqësojë BD- në në takimet e ndryshme në mekanizmat institucional qeveritar dhe joqeveritar.
- 9) Ka të drejtë të organizojë tryeza të rrumbullakëta dhe konferenca me tematika të ndryshme.



Neni 16 **NËNKRYETARËT**

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- 1) Janë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së organeve të BD-së.
- 2) Koordinojnë punët me organet e partisë dhe udhëheqin me sektorët me të cilat ngarkohen nga organet e partisë: Kuvendi, Këshilli i Përgjithshëm, Kryesia dhe Kryetari.
- 3) Janë në kontakt të vazhdueshëm me degët dhe nëndegët e partisë për koordinim dhe zbatim të detyrave dhe obligimeve programore e statutare.
- 4) Drejtojnë grupet punuese të sektorëve me të cilët i ngarkojnë organet e partisë.
- 5) Roli i nënkryetarëve të një partie qendrore është të ndihmojnë në drejtimin dhe menaxhimin e partisë, të mbështesin kryetarin në detyrat e tij dhe të përfaqësojnë partinë në ngjarje dhe aktivitete të ndryshme.
- 6) Nënkyetarët mund të kenë përgjegjësi të ndryshme, të tilla si organizimi i aktiviteteve të partisë, koordinimi i komiteteve, ose mbikëqyrja e zhvillimeve të brendshme dhe strategjike.
- 7) Për punën e tyre i përgjigjen Kryetarit, Kuvendit dhe Këshillit të Përgjithshëm.
- 8) Kryejnë punë dhe detyra sipas nevojës.

Neni 17 **KRYESIA**

- 1) Kryesia është organ ekzekutiv dhe përbëhet nga Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm, nënkryetarët, kryetarë degësh dhe anëtarë tjerë të partisë.
- 2) Zbaton detyrat e Kuvendit dhe të Këshillit të Përgjithshëm.
- 3) Fton Këshillin e Përgjithshëm dhe Kuvendin.
- 4) Përgatitë materialet dhe i shpërndanë ato.
- 5) Vendosë për krijimin e fondeve të caktuara.
- 6) Sipas nevojës krijon trupat punuese.
- 7) Komunikon me mediat e shkruara dhe ato elektronike.
- 8) Sipas nevojës u dërgon materiale organizatave qeveritare dhe joqeveritare.
- 9) Për punën e vet i raporton Këshillit të Përgjithshëm dhe Kryetarit.
- 10) Anëtarë i Kryesisë, që udhëheq një komision, ka të drejtë ta plotësojë komisionin me anëtarë profesionistë jashtë Kryesisë dhe Këshillit të Përgjithshëm.
- 11) Kryesia mund ta suspendon çdo anëtar të saj, deri në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm, kur do të vendoset për shkarkim apo jo.
- 12) Ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore, Kryesia kryen punë nga kompetencat e Këshillit të Përgjithshëm për të cilat kërkohen me urgjencë.
- 13) Në raste të jashtëzakonshme Kryesia mund ta thërras takimin e Këshillit të Përgjithshëm.
- 14) Vendimet i merr me shumicë të thjeshtë votash.
- 15) Përgatitë Raportin e Planin Vjetor të Punës dhe atë financiar të cilat i vë para Këshillit të Përgjithshëm për diskutim e miratim.
- 16) Përcjell zbatimin e Planit të punës të Këshillit të Përgjithshëm dhe propozon masat për realizimin e tij.
- 17) Propozon nxjerrjen e akteve të brendshme (rregulloreve të punës) me qëllim të mbarëvajtjes së punëve.
- 18) Formon komisione dhe trupa punuese në bazë të kompetencave të veta.
- 19) Propozon formimin e shërbimeve profesionale.
- 20) Merr vendime të natyrës urgjente të cilat më vonë i verifikon Këshilli i Përgjithshëm.



21) Kryen edhe punë tjera sipas autorizimeve të Këshillit të Përgjithshëm.

SEKRETARI JURIDIK

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- 1) Organizon takimet e Kryesisë, Këshillit të Përgjithshëm dhe të Kuvendit.
- 2) Është përgjegjës për çështje juridike.
- 3) Udhëheq dhe mbikëqyrë punën e Shërbimit profesional të BK-së.
- 4) Mbajtja e procesverbaleve të takimeve BD-së.
- 5) Arkivon dokumentacionin e të BD-së.
- 6) Angazhohet për mbarëvajtjen e punës ligjore dhe statutare të BD-së.
- 7) Ofron ndihmë teknike dhe profesionale për Kryetarin Sekretarin e Përgjithshëm dhe Kryesinë e BD-së.
- 8) Kryen edhe punë tjera të rekomanduara nga organet e BD-së.

Neni 18

KOMISIONI I REVIZIONIT DHE KONTROLLIT

- 1) Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë të cilët i zgjedh Këshilli i Përgjithshëm.
- 2) Këshilli mbikëqyrës bën mbikëqyrjen e punës rreth përcaktimit të përdorimit të mjeteve materiale.
- 3) Kontrollon Raportin vjetor të buxhetit.
- 4) I propozon Kryesisë dhe Këshillit të Përgjithshëm ndarjen e mjeteve materiale.
- 5) I raporton me shkrim Këshillit të Përgjithshëm për rezultatet e mbikëqyrjes.

Neni 19

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE STATUTORE

- 1) Në rast të paqartësive apo vështirësive tjera në zbatimin e çfarëdo dispozite të këtij Statuti, interpretimi i Komisionit për çështje statutoire është përfundimtar dhe i obligueshëm për të gjitha organet e Bashkimit Demokratik (BD).
- 2) Komisionin për çështje statutoire e zgjedh Kryesia e BD dhe ai komision duhet të ketë pesë (5) antarë, kryesisht jurist dhe njohës të çështjeve programore e ligjore, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë nga Kryesia e BD-së.
- 3) Komisionin për çështje statutoire merr vendime me shumicë të thjeshtë, ndërsa mban mbledhje, sipas nevojës dhe pas paraqitjes së rasteve për interpretim të statutit.

Neni 20

ANËTARËSIMI

- 1) Çdo shtetas i rritur, i aftë ligjërisht i Republikës së Kosovës, i cili pranon Statutin, Kodin e Etikës, programin dhe qëllimet e saj, mund të bëhet anëtar i Partisë “Bashkimi Demokratik”.
- 2) Për t'u bërë anëtar i Partisë, personi i interesuar duhet të jetë përfshirë më parë në aktivitetet e partisë përmes punës në grupe tematike ose operacionale për të paktën **tre muaj** para paraqitjes së kërkesës për anëtarësim.
- 3) Personi bëhet anëtar i Partisë duke u regjistruar në listën e anëtarëve, në bazë të vendimit të Kryesisë së Partisë për pranimin e anëtarësimit.



Anëtarësimi pushon:

- 1) Kur anëtari ç'regjistrohet
- 2) Kur shkel statutin e BD-së
- 3) Kur vdes

Neni 21
ARKATARI

- 1) Përgjegjës për çështjen e Arkës së Bashkimit Demokratik
- 2) Zgjidhet nga kryesia e partisë

Neni 22
BARAZIA GJINORE DHE PËRFAQËSIMI NË ORGANET E BD

Ndër synimet kryesore të BD gjatë aktivitetit të saj politik janë:

- 1) Reformimi i administratës ekzistuese sipas parimeve të univerzalitetit, emancipimit, drejtësisë dhe barazisë gjinore
- 2) Sigurimi i barazisë gjinore dhe të grupeve tjera në të gjitha fushat e jetës, parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe mbrojtja e të drejtave riprodhuese të grave.
- 3) Promovimi i pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje, nëpërmjet vendosjes së një ekuilibri gjinor në marrjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke synuar një përfaqësim me kuota gjinore prej 1/3 të anëtarëve të gjinisë femërore në të gjitha organet, komisionet dhe strukturat e BD-së.

Neni 23

SHPËRBËRJA APO SHUARJA E PARTISË

- 1) Me rastin e shpërbërjes apo shuarjes së Partisë, së pari përmbushen detyrimet ndaj palëve të treta ndërsa për pjesën e mbetur, janë kompetente organet e partisë. Në rast se nuk ka dakordim nga organet përkatëse, asetet financiare dhurohen për bamirësi.
- 2) Vendimet në rast të shpërndarjes apo shuarjes së Partisë, bashkimit ose shkrirjes së partisë në një parti tjetër, mjeteve të punës dhe asetëve tjera, merren ekskluzivisht nga Kuvendi i Partisë.

Neni 24

HYRJA NË FUQI

- 1) Interpretimin e dispozitave të Statutit e bën:
 - Kuvendi i BD-së
 - Këshilli i Përgjithshëm
 - Kryesia pasi ta merr mandatin
 - Komisioni Statutar

Sipas Nenit 19, interpretimi i Komisionit për Çështje Statutore është përfundimtar.

- 2) Statuti mund të rishikohet apo ndryshohet nga Kuvendi me shumicën e kualifikuar (2/3) të anëtarëve të tij.
- 3) Ky Statut hynë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Nismëtar i Bashkimit Demokratik dhe vlen deri në aprovimin e plotfuqishëm të këtij Statuti nga Kuvendi i BD.